



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**



*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike / Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost /  
Kosovo Academy for Public Safety**

Nr. KA 01/2015

Datë: 10.08.2015

Duke u bazuar në dispozitat e vendimit nr. 1/17 të datës 07.08.2015 të nxjerrë nga Këshilli i Përkohshëm i Fakultetit të Sigurisë Publike, Komisioni Ad hoc për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithë ankesave të paraqitura pranë këtij komisioni, në mbledhjen e mbajtur më datë 10 gusht 2015 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET** ankesa e kandidatit Ferat Ferataj (punonjës i SHKK-së) dhe pranohen në vitin e parë të studimeve 2015/16 në Fakultetin e Sigurisë Publike/AKSP.
- II. **REFUZOHEN** ankesat e kandidatëve si të pabazuara për kandidatët me përshkrimet si në vijim:

Nr.	Nr. i protokollit	Agjencioni	Kandidati	Pikët në regjistrin preliminar	Pikë e konstatuara me rastin e shqyrtimit të ankesave
1.	46/456	PK	Feriz Mehmeti	63	63
2.	47/467	PK	Berat Aliu	61	61
3.	47/466	PK	Kasim Behrami	61	61
4.	46/460	PK	Bujar Syla	60	60
5.	47/462	PK	Muhamet Vitia	60	60
6.	47/461	PK	Arbnor Islami	57	57
7.	48/471	PK	Arijetë Robelli	56	56
8.	47/470	PK	Bekim Ademi	54	54
9.	47/465	PK	Fitim Mustafa	54	54
10.	47/463	PK	Jeton Halili	53	53
11.	46/455	PK	Suad Murati	53	53
12.	46/457	PK	Izet Haliti	50	50
13.	47/465	PK	Ismet Osmani	49	49
14.	46/459	PK	Xhavit Selimi	46	40
15.	47/468	PK	Naxhie Gashi	28	28
16.	47/469	SHKK	Samet Ferataj	49	49

- III. **NDRYSHOHET** regjistri preliminar i rezultateve të shpallura për Fakultetin e Sigurisë Publike dhe rangimi në regjistrin përfundimtar bëhet duke marrë parasysh pikët e kandidatëve të konstatuara me rastin e shqyrtimit të ankesave sikurse janë cekur në pikën I dhe II të këtij vendimi.

IV. Vendimi është përfundimtar dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

### ARSYETIM

Komisioni Ad hoc për shqyrtimin e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesave të kandidatëve ka evidentuar se 17 kandidatë kanë paraqitur ankesë dhe të gjitha janë protokolluar pranë njësisë përkatëse.

Me rastin e shqyrtimit të ankesave komisioni ka ftuar të gjithë kandidatët që kanë parashtruar ankesë dhe ata që kanë kërkuar shikimin e testit për provim pranues në Fakultetin e Sigurisë Publike. Komisioni së bashku me kandidatët që kanë kërkuar një gjë të tillë, në prani të tyre ua ka prezantuar testin.

Gjatë shqyrtimit të ankesave, komisioni ka konstatuar se ankesa e paraqitura nga kandidati në pikën I të këtij vendimi është e bazuar. Kandidati Ferat Ferataj është punonjës i Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën Mbikëqyrës i lartë dhe është bërë gabim teknik me rastin e bartjes së rezultatit të arritur në provim pranues në listen e shpallur të kandidatëve të agjencionit të Policisë së Kosovës. Si e tillë, ankesa e z.Ferat Ferataj ka bazë dhe rrjedhimisht ka fituar kushtin të jetë student në vitin e parë akademik 2015/16 sipas drejtimit përkatës që ka konkuruar pasi që ka grumbulluar 60 pikë dhe rangohet me numër 6 në listën e kandidatëve të pranuar të agjencionit Shërbimi Korrektues i Kosovës.


Komisioni gjithashtu gjatë punës në shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se kandidatët sikurse janë përmendur në pikën II të këtij vendimi, ka vërejtur se ankesat e tyre nuk kanë bazë pasi që edhe pas shikimit të detajuar të testit nga ana e komisionit në prani të kandidatëve që kanë paraqitur ankesë, të njejtit kandidat nuk kalojnë pragun e kalueshmërisë për të fituar rangimin në listën e kandidatëve të pranuar.

Nga arsyet e cekura më sipër është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Vushtrri, më 10.08.2015

Komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesave

1. Shpend Shabani, kryesues;
2. Sahit Surdulli, anëtar;
3. Anita Zenuni, anëtar;
4. Vilard Bytyqi, anëtar;
5. Kastriot Jashari, anëtar;



**Vendimi iu dërgohet:**

- Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së;
- Këshillit të Përkohshëm të Fakultetit për Siguri Publike;
- Divizionit për Shërbime Studentore, dhe
- Arkivit të AKSP-së.